

K O N T R A T A

E THEMELIMIT TE SHOQERISE TREGTARE "KROI-OS" ME PERGJEGJESI
TE KUFIZUAR (SHPK)

Bazuar ne Ligjin Nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite private", themelohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar (shpk) "KROI-OS" nga ortaket:

1. NIKOLLA ÇAÇI, i biri i Stefanit dhe i Elenit, i datlindjes 04.04.1957, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Sarande. Me pasaporte Nr.QH257295.
2. JAHO SKENDERI, i biri i Demos dhe i Sabies, i datlindjes 03.03.1966, lindur ne Lazarat Gjirokaster dhe banues ne Gjirokaster. Me Nr. leternjoftimi NF 232737.

Neni 2

SELIA e Shoqerise do te jete ne qytetin e Tiranes, Kilometri 4, rruga Tirane-Durres. Ajo mund te hape vendqendrimet tjera edhe ne rrethet tjera sipas shtrirjes se saj ekonomike.

Neni 3

Shoqeria ka kohezgjatjen e veprimtarise se saj deri ne 10 vjet. Permbajtja e Kontrates dhe kushtet e saj te percaktuara ne te, do te perpilohen gjithnje me shkrim.

Neni 4

Ne fillim te veprimtarise ekonomiko-financiare Shoqeria disponon nje kapital prej 100.000 lekesh (njegjindmije) te investuar nga ortaket me keto perpjestime:

1) NIKOLLA ÇAÇI 50% dhe 2) JAHO SKENDERI 50%

Neni 5

Veprimtaria e Shoqerise do te jete: "Import-eksport, tregetim me shumice e pakice, transport te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, elektrike, shtepiake, elektrike, karburant lubrifikant dhe gaz, turizem, bime medicinale, materiale kimike e farna per bujqesi e blegtori. Prodhim te material

plastike,ndertimi,elektrike,kimike etj."

Neni 6

Kapitali i Shoqerise mund te shtohet sipas rritjes se veprimtarise ekonomike te saj.Te ardhurat do te sigurohen nepermjet veprimtarise private,te percaktuar ne nenin 4 te kesaj kontrate.

Neni 7

Fitimet e arritura ne veprimtarine e tyre private ortaket do t'i ndajne ne menyre te barabarte.

Neni 8

Pjestaret ne Shoqeri kane te drejte te japin mendime,te kontrollojne veprimet financiare qe do te kryej Shoqeria e tyre.

Neni 9

Ortaket duhet te jene pergjegjes per qdo thyerje te rregullave ligjore, ekonomike e financiare te veprimtarise se tyre.

Neni 10

Ortaket kane per detyre te marrin pjese ne rreziquet e veprimtarise se Shoqerise deri ne masen e plote te kapitalit financiar.

Neni 11

Kontrata nenshkruhet nga ortaket ne baze te statutit te miratuar prej tyre per krijimin e Shoqerise Private Tregtare (shpk)te emertuar SHOQERIA TREGTARE "KROI-OS" sh p k.

Neni 12

Kontrata eshte e vlefshme deri ne 10 vjet kohe,me te drejte te riperte-ritjes me miratimin e ortakeve.Ne raste te mosplotesimit te detyrimeve, secili ortak ka te drejte te kerkoje zgjidhjen e kontrates brenda 30 diteve.Largimi nga Asambleja e Ortakeve (Ortakeria)nuk i shmang ato nga detyrimet dhe te drejtat qe rrjedhin nga statuti i shoqerise,qe lidhen njekohesisht para largimit nga Shoqeria.

Neni 13

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne mes te ortakeve dhe midis personave te trete fizike apo juridik,apo te marrjes ne pune,sipas kontrates se

punes, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert, ruhet e drejta e zgjidhjes se tyre ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes sipas statutit te Shoqerise dhe te kesaj kontrate si dhe te kontrates se punes duke zbatuar kerkesat e legjislacionit te punes ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14

Kontrata eshte hartuar ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, e cila pasi u lexua nga ortaket dhe u miratua prej tyre, nenshkruhet pa asnje verëjtje. Kjo kontrate hyn ne fuqi pasi nenshkruhet nga palet.

Kontrata u nenshkrua sot me datën 25.04.1997

O R T A K E T

1) NIKOLLA ÇAÇI

dhe

2) JAHO SKENDERI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 1770 REP. NR. 664 KOL.V E R T E T I M

Sot, me datën 25.04.1997 (nëntëdhjetë shtatë) u paraqiten personalisht para meje Noteres, Ortaket themelues te Shoqerise Tregtare (shpk) "KROI-OS" me SELI ne Tirane, Kilometri 4, rruga "Tirane-Durres shtetasit 1) Nikolla Çaçi dhe 2) Jaho Skenderi madhor me zotësi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet e tyre personale te cilet me deklaruan se statutin dhe kontraten e themelimit te kesaj Shoqerie e kane hartuar jashte kesaj zyre me deshiren dhe pelqimin e tyre te plote dhe e nenshkruan para meje, ndersa une e vertetoj ate sipas ligjes.



N O T E R E



S T A T U T I
=====



I
SHOQERISE TREGTARE "KROI-OS" SH P K
=====

Ortakët: NIKOLLA ÇAÇI dhe JAHO SKENDERI themelues të Shoqerisë Tregtare "KROI-OS" (shpk), veç nënshkrimit të kontratës për themelimin e kësaj Shoqërie, hartuan e nënshkruan edhe statutin e saj me këto përmbajtje:

KREU I

DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "KROI-OS" shpk me seli në Tiranë, Kilometri 4, rruga Tiranë-Durrës, në përputhje me Vendimin për krijimin e Shoqërisë në fjalë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, rregullon pozitën juridike të themeluesve dhe të punonjësve në këtë Shoqëri, të dhënat me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e saj.

Neni 2

Shoqëria, sipas nenit 1 të këtij statuti, krijohet me mjetet vetiake të themeluesve dhe të (punonjësve) me karakter prone private.

Neni 3

Shoqëria "KROI-OS" shpk sipas neneve 1 dhe 2 të këtij statuti, do të ushtroje veprimtarinë e saj me emërtimin: SHOQERIA TREGTARE (SHPK) "KROI-OS".

Neni 4

Shoqëria ka statutin e personit juridik.

Neni 5

SELIA E SHOQERISE është në Tiranë, kilometri 4, rruga Tiranë-Durrës.

Neni 6

Shoqëria ka vulën e saj. Vula ka formë të rrumbullakët me madhësi të zakonshme dhe rreth e qark saj është shkruar teksti: SHOQERIA TREGTARE SHPK "KROI-OS".

Në mesin e vules është vendosur sigla e Shoqërisë "KROI-OS"

Neni 7

OBJEKTI i veprimtarise se Shoqerise "KROI-OS" Shpk do te jete:
 "Import-eksport, tregetim me shumice e pakice, transport te: mallrave te
 ndryshme industriale, ushqimore, elektroshtepiake, elektrike, karburant
 lubrifikant dhe gaz, turizem, bime mediacionale, materiale kimike e farna
 per bujqesi e blegtori. Prodhim te materialeve plastike, ndertimi, elektrike,
 kimike etj".

Neni 8

Shoqeria e ushtron veprimtarin e saj te percaktuar ne kete statut ne
 te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Per kryerjen e kesaj
 veprimtarie Shoqeria mund te çele dege dhe zyrat e saj te perfaqsimi
 ne vend dhe jashte shtetit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe
 me legjislacionin e vendit te huaj ku çelen ato si dhe te bashkepunojë
 dhe me firma te huaja.

Neni 9

Shoqeria e kryen veprimtarin e saj per te realizuar fitimin, duke u
 mbështetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

Neni 10

Pjesmarrja ne Shoqeri nuk i pengon ortakët qe te kene pavaresine ligjore
 per veprimtari te tjera dhe per te drejta pronesie. Ortaket qe marrin
 pjese ne Shoqeri nuk i nënshtrohen asaj si persona.

Neni 11

Ortakët kane keto te drejta kryesore:

- 1-Te marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se Shoqerise ne perputhje me kontraten e themelimit dhe me statutin, vete ose nepermjet perfaqsesit te tyre.
- 2-Te marrin pjese ne rezultatet e veprimtarise se Shoqerise ne çdo forme e sasi qofte, ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- 3-Te marrin pjese ne organet e Shoqerise, te cilet jane ose mund te krijohen vete, ose nepermjet perfaqsesit te tyre.

4-Te kerkojne dhenien e informatave qe kane te bejne me gjendjen prodhuese e tregtare te Shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga Shoqeria si dhe bilancet, llogarite ekonomike etj.

5-Te bejne propozime dhe t'i paraqesin ato per shqyrtim prane organeve te Shoqerise.

Neni 12

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

1-Te depozitojne kuoten e tyre ne perputhje me aktin (kontraten) e theme- limit te Shoqerise dhe me kete statut.

2-Te marrin pjese ne administrimin e Shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tyre, vete ose nepermjet perfagesuesve qe i caktojne ato.

3-T'i japin Shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.

4-T'i japin Shoqerise e te kryejne sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave dhe te realizimit te veprimtarise se saj.

Neni 13

Secili ortak pjesën e vet të kapitalit themelor mund ta transferojë në persona të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, por vetëm miratimin e Ortakëve të tjerë.

Projektvendimi për transferimin i njoftohet Shoqërisë dhe secilit ortak. Në rast se Shoqëria nuk e ka bërë të ditur vendimin e saj, brenda tre muajëve nga data e njoftimit, miratimi i transferimit konsiderohet i dhënë. Në rast se Shoqëria refuzon të japë miratimin e transferimit, secili ortak brenda tre muajëve nga data e këtij refuzimi, duhet të blejë ose të lejojë blerjen e pjesëve të kapitalit themelor me vlerën e përcaktuar sipas rregullave të parashikuara në nenin 11 të Ligjit "Për shoqëritë tregtare".

KREU II

KUSHTET EKONOMIKE

Neni 14

Veprimtaria e Shoqërisë realizohet në bazë të parimeve të llogaritë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

Neni 15

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise caktohet nje kapital themelor prej 100.000 lekesh. Ortaket marrin nje pjese ne krijimin e kapitalit themelor te Shoqerise me kuotat e tyre te barabarta. Afatet e derdhjes se kapitalit themelor te Shoqerise, te ndara ne kuota per secilin ortak, depozitohen ne Banke per llogari te Shoqerise nga Administratori i saj. Ky i fundit u dorezon ortakeve nje dokument, me te cilin vertetohet derdhja e kuotave ne te holla prej tyre.

Neni 16

Shoqeria ne emer te saj eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te bleje pasuri ose te shfrytetoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasurite e saj per te marre kredi bankare.

Neni 17

Shoqeria krijon fondin rezerve ose edhe fonde te tjera te veganta financiari per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj. Ajo i disponon plotesisht mjetet e veta financiare.

Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se saj mbulohen nga fonde rezerve, nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare qe, kur deshirojne ortaket, mund te derdhen prej tyre, ne rastet kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga fondet ekzistuese. Fitimi i realizuar nga Shoqeria gjate nje viti ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjesen e kapitalit te derdhur nga secili ortak.

KREU III
ADMINISTRIMI

Neni 18

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve, e cila vendos me unanimitet per te gjithë çështjet qe merr ne shqyrtim, si per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin ose pakesimin e kapitalit themelor, per emerimin e administratorëve, te drejtorit te pergjithshem e shkarkimin e tyre, per percaktimin e drejtimeve kryesore te veprimtarise se Shoqerise si dhe per shkrirjen ose mbylljen e saj.

Neni 19

Asambleja e Ortakeve mblidhet rregullisht njehere ne çdo tre muaj dite ne fundit te muajit te trete.

Me kerkesen e çdo ortaku, te administratorit ose te drejtorit te pergjithshem, Asambleja e Ortakeve mund te mblidhet edhe jashte radhes. Ortaket , per mbledhjen e Asamblese dhe per rendin e dites lajmerohen te pakten 15 dite perpara mbledhjes me njoftim me shkrim.

Çdo mbledhje e thirrur ne menyre te parregullt mund te anulohet prej ortakeve. Megjithate anullimi i mbledhjes se Asamblese se Ortakeve nuk ka vlere ne raste se te gjithë ortaket ose perfaqsesit e tyre jane te pranishem ne mbledhje. Secili ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese dhe te votoje per çështjet qe shqyrtohen duke patur te drejte vote te barabarte me ortaket e tjere.

Neni 20

Ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve ose edhe ne konsultimet e saj me shkrim per çështje te caktuara, vendimet merren me unanimitet.

Asambleja e Ortakeve, kur nuk siguron unanimitet me marrjen e vendimeve, per çështje te rendesishme si per pranimin e ortakeve te rinj ne shoqeri, per zhvillimin e operacionave tregtare me vlere 100000 dollare ose per pushimin e zvoglimin e veprimtarise se shoqerise, ne votim, me te drejte vote te barabarte therret Drejtorin e Pergjithshem. Ne keto raste, per

çeshtjet që shtrohen për diskutim, vendoset me shumicë votash.

Neni 21

Organ Administrativ i Shoqërisë është administrata ose administratoret, që zgjidhen nga Asambleja e Ortakëve.

Administratori i përfaqëson Shoqërinë kundrejt të tretëve brenda qagëve të veprimtarisë së saj si edhe kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të Shoqërisë.

Kompetencat ekskluzive të Administratorit të Shoqërisë janë:

1. Të miratojë planet e llogarite ekonomike, pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së Shoqërisë.
2. Të bëjë propozimet e nevojshme në Asamblenë e Ortakëve për ndryshimin e pakesimit të kapitalit themelor të Shoqërisë, kur lind nevoja.
3. Të miratojë akte normative, që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
4. Të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqërisë.
5. Të krijojë organet e tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
6. Të propozojë në Asamblenë e Ortakëve për krijimin e njësive strukturore si filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose në qendrat e banuara.
7. Të përgatisë propozimin për pushimin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe t'ia paraqesë atë Asamblese së Ortakëve për miratim.
8. Të përzgjedhë ekspertet kontabel dhe anëtarët e Komisionit të Likuidimit dhe të paraqesë propozimet për miratim në Asamblenë e Ortakëve.
9. Të përzgjedhë ekspertet kontabel, të përcaktojë numrin e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre.
10. Të përfaqësojë Shoqërinë përpara të tretëve në organet gjyqësore, në Arbitrazh dhe në organet e tjera shtetërore.

Administrator i Shoqërisë miratohet z. NIKOLLA ÇAÇI.

Neni 22

Veprimtaria Operative e Shoqerise udhëhiqet nga Drejtori i Pergjithshem i saj, i cili perben organin ekzekutiv.

Drejtori i Pergjithshem, ne kuadrin e kompetencave te tij, te percaktuara ne kete statut dhe ne vendimet e Asamblese se Ortakeve, vepron ne te gjithë sektoret e Shoqerise per ndjekjen dhe realizimin e veprimtarise se percaktuar ne objektin e saj.

1-Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe lidhen me Asamblene e Ortakeve dhe me administratoret. Drejtor i i pergjithshem emerohet z.JAHO SKENDERI.

KREU IVKOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 23

Afati i veprimtarise se Shoqerise caktohet per nje periudhe kohe prej 10 vjetesh.

KREU VMARDHENIET E PUNES

Neni 24

Mardheniet e punes ne Shoqeri rregullohen ne perputhje me Vendimin per krijimin e Shoqerise, me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe me kete statut.

Neni 25

Punesimi i punonjesve ne Shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive te punes, ne te cilen percaktohen paga e punes, mbrojtja dhe kushtet e punes, shperblimi i punes se secilit dhe shperblime te tjera.

KREU VIIMBYLLJA E SHOQERISE

Neni 26

Veprimtaria e Shoqerise perfundon e percaktuar ne aktin e themelimit me pare, sipas propozimit te bere prej njerit nga ortaket, kur gj vjeteve te njepasnjeshme veprimtaria e saj rezulton jo rentabel shperndahet ne forme riorganizimi ose liuidimi.

Neni 27

Mjetet financiare si edhe çdo pasuri tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise, ne rastin kur Shoqeria likujdohet ndahen ndermjet ortakëve, ne perpjestim me kuotat e tyre perkatese ne kapitalin themelor, pasi te jene kryer pagesat ndaj kreditoreve.

Neni 28

Ky statut hartohet ne kater kopje dhe nenshkruhet rregullisht nga ortakët themelues te Shoqerise sot, me daten 25.04.1997.

ORTAKET :

1) NIKOLLA ÇAÇI

2) JAHO SKENDERI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA e NOTERISE TIRANE

Nr. 1768 Rep. Nr. 663 Kol.VERTETIM

Sot me daten 25.04.1997 (nentedhjeteshtate) u paraqiten ne Zyren e Noterise Tirane para meje Noteres, Ortaket e Shoqerise Tregtare "KROI-OS" shpk madhor me zotesi juridike per te vepruar te cilet me deklaruan se jane dakort me kete statut te kesaj Shoqerie te hartuar jashte kesaj zyre, te cilen e nenshkruan para meje rregullisht dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE

(*Noterja*) *Pe 37*